

Bucaj International Sh.p.k.

Pasqyrat financiare

per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019

(dhe raporti i audituesit te pavarur)

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR	i-iii
Pasqyra e pozicionit financiar.....	1
Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve	2
Pasqyra e te ardhurave te tjera gjithepershiresë	3
Pasqyra e ndryshimeve ne kapital	4
Pasqyra e flukseve monetare	5
1. Informacion i pergjithshem	6
2 Baza e pergatitjes.....	6
3 Permbledhje e politikave kontabel.....	6
4 Percaktimi i vleres se drejte.....	10
5 Manaxhimin i riskut financiar	10
6 Mjete Monetare.....	12
7 Te drejta te arketueshme tregtare.....	12
8 Te drejta te arketueshme te tjera.....	13
9 Te drejta te arketueshme nga palet e lidhura	13
10 Inventar	13
11 Aktive materiale.....	14
12 Aktive jomateriale.....	15
13 Hua afatshkurter	15
14 Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	15
15 Te pagueshme per palet e lidhura.....	16
16 Kapitali i nenshkruar	16
17 Te ardhura nga aktiviteti kryesor	16
18 Te ardhura te tjera	16
19 Lende e pare dhe materiale te konsumueshme.....	17
20 Shpenzime te personelit	17
21 Shpenzime te pergjithshme dhe administrative.....	17
22 Shpenzime financiare	18
23 Palet e lidhura.....	18
24 Ngjarje pas dates se raportimit	199

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

Per Drejtimin e Shoqerise Bucaj International shpk

Opinionin me Rezerve

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqerise Bucaj International Shpk, te cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2019, pasqyrën e fitim ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e flukseve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë si dhe shënimet shpjeguese te pasqyrave financiare, duke përfshire dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabile.

Sipas opinionit tonë, pervec ceshtjes se pershkruar ne seksionin Bazat per Opinionin me Rezerve pasqyrat financiare bashkëlidhur japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2019, rezultatin financiar dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë në përputhje me Standardet Kombetare te Kontabilitetit (“SKK”) miratuar me Ligjin Nr.9228 datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” ne Shqiperi.

Baza per opinionin me Rezerve

Ne nuk ishim vendosur si auditues të Shoqërisë deri me 31 Dhjetor 2019, dhe keshtu që ne nuk morëm pjesë në vëzhgimin e procesit të numërimit të inventarit me 31 Dhjetor 2019. Sic shpjegohet në shenimin nr.10 te pasqyrave financiare inventari i shoqerise ne daten 31 Dhjetor 2019 është në vlerën prej 11,334,915 Lek (31 Dhjetor 2018: 0 Lek). Ne e kishim të pamundur të fitonim siguri me mënyra të tjera alternative për sasi të inventarit të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar me 31 Dhjetor 2019. Si rrjedhojë, ne nuk mund të percaktonim nëse ndonjë rregullim do të ishte i nevojshëm në lidhje me inventarin me 31 Dhjetor 2019, si edhe përkatësisht në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin që mbyllet me 31 Dhjetor 2019.

Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNAs). Përgjegjësia jone sipas këtyre standardeve përshkruhet ne vijim ne seksionin e raportit tone Pergjegjesia e Audituesve per Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqeria në përputhje me kërkesat etike që janë te rendesishme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe i kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Ceshtje te tjera

Pasqyrat financiare për periudhën që mbyllet nga data e themelimit 3 Dhjetor 2018 deri me 31 Dhjetor 2018 nuk janë te audituara. Pasqyrat për periudhën paraardhëse që mbyllet nga data e themelimit 3 Dhjetor 2018 deri me 31 Dhjetor 2018 janë paraqitur ne konsistencë me klasifikimin e zërave për periudhën që mbyllet me 31 Dhjetor 2019.

Përgjegjësia e Drejtimit dhe Personave të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK miratuar me Ligjin Nr.9228 datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë nga mashtrimi apo pasaktësia.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar në kushtet e vijimësisë së biznesit, zbulimin, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me vijimësinë dhe përdorimin e bazës së vijimesisë të kontabilitetit, përveç rasteve kur drejtimi synon të likuidojë Shoqërinë ose të pushojë veprimtarinë, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër realiste përveç kesaj.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë dhenia e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi janë pa gabime materiale, qoftë nga mashtrimi apo pasaktësia, dhe dhenia e raportit të audituesve që përfshin opinionin tonë. Siguri e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk është një garanci që një kontroll i kryer në përputhje me SNA gjithmonë do të zbulojë një anomali materiale, kur ajo ekziston. Anomali mund të lindin nga mashtrimi apo pasaktësia dhe konsiderohen si materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato pritet që të ndikojnë vendimet ekonomike të marra nga përdoruesit mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo pasaktësive, planifikojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit, që u pergjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi, që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për bazat e opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një keqdeklarimi material, që vjen nga mashtrimi është më i lartë se ai që vjen nga gabimet, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, mospërfshirje të qëllimshme, keq paraqitje, apo tejkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit, që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të njesisë ekonomike.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shënimeve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga drejtimi të parimit të vijimësisë në kontabilitet dhe, duke u bazuar në evidencën e marrë gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet ose rrethanat që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi aftësinë e njesisë ekonomike për të vazhduar në kushtet e vijimësisë së biznesit. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit për paraqitjen e këtij informacioni në shënime shpjeguese të pasqyrave financiare ose, nëse keto shënime janë të papërshtatshme, për të modifikuar opinionin tonë.
- Në rastet e një misioni për auditimin e një grupi, marrim evidenca auditimi, që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënat financiare të njesive ekonomike ose aktivitetëve tregtarë brenda grupit për të shprehur një opinion për pasqyrat financiare të grupit. Ne jemi përgjegjës për drejtimin, mbikëqyrjen dhe cilësinë e auditimit të grupit. Ne jemi të vetmit përgjegjës për opinionin e auditimit.

Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarje ose rrethana në të ardhmen mund të detyrojnë njesinë ekonomike të mos vazhdojë më në kushtet e vijimësisë së biznesit.

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisje në lidhje me, midis çështjeve të tjera, qëllimin e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Midis çështjeve që ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisjen, ne përcaktojmë, nese ka, ato çështje që kanë qënë më të rëndësishmet për auditimin e pasqyrave financare të periudhës aktuale dhe rrjedhimisht janë çështje kryesore auditimi. Ne i përshkruajmë keto çështje në raportin tonë të auditimit përveç rasteve kur ligjet apo rregulloret e ndalojnë paraqitjen publike të çështjes ose kur, në raste shumë të rralla, ne vendosim që një çështje nuk duhet komunikuar në raportin tonë të auditimit sepse ndikimi negativ që do kishte, do të tejkalonte mjaftueshëm përfitimet e interesit publik të këtij komunikimi.

Baker Tilly Albania shpk

Orjana Kalaja
Auditues Ligjor

Tiranë
25 korrik 2020



Bucaj International Shpk

Pasqyra e pozicionit financiar per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019

(Vlerat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

Pasqyra e pozicionit financiar

Shenime	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018 Te pa audituara
AKTIVET		
Aktive afatshkurtra		
Mjete monetare	6 6,334,671	-
Te drejta te arketueshme	7 27,560	-
Te drejta te arketushme te tjera	8 17,896,795	1,599,885
Te arketueshme nga palet e lidhura	9 60,982,500	100,000
Inventar	10 11,334,915	-
Totali i aktiveve afatshkurtra	96,576,441	1,699,885
Aktive afatgjate		
Aktive materiale	11 73,972,792	92,448
Aktive jomateriale	12 2,689,647	-
Totali i aktiveve afatgjate	76,662,438	92,448
TOTALI I AKTIVEVE	173,238,880	1,792,333
DETYRIMET DHE KAPITALI		
Detyrime afatshkurtra		
Hua afatshkurter	13 1,156,815	-
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	14 19,907,211	1,761,620
Te pagueshme per palet e lidhura	15 36,804,017	-
Totali i detyrimeve afatshkurtra	57,868,043	1,761,620
Detyrime afatgjate		
Detyrime afatgjate	-	-
Totali i detyrimeve afatgjate	-	-
Totali i detyrimeve	57,868,043	1,761,620
Kapitali dhe rezervat		
Kapitali i nenshkruar	16 123,200,000	100,000
Humbja e akumuluar	(69,287)	-
Humbja e vitit	(7,759,875)	(69,287)
Totali i kapitaleve te veta	115,370,838	30,713
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT	173,238,880	1,792,333

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 deri 19 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare te shoqerise per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019 jane aprovuar nga administratori is shoqerise Bucaj International shpk me 25 korrik 2020.

Shkumbin Mucolli

Administrator

Shkumbin Mucolli
S.M.



Loela Sterjo

Shefe e Finances

Loela Sterjo
L.S.

Bucaj International Shpk

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019

(Vlerat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve

	Shenime	Per periudhen 1 janar 2019 deri me 31 dhjetor 2019	Per periudhen nga 3 dhjetor 2018 deri me 31 dhjetor 2018 Te pa audituara
Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit			
<i>Te ardhurat nga aktiviteti kryesor</i>	17	99,540,105	-
<i>Te ardhurat nga aktivite te tjera</i>	18	3,528,863	-
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	19	(49,456,065)	-
Shpenzime të personelit	20	(23,083,953)	(28,008)
Shpenzime te pergjithshme dhe administrative	21	(32,075,470)	(41,279)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	11,12	(6,360,235)	-
Shpenzime financiare, neto	22	146,880	-
Fitimi/(Humbja) para tatimit		(7,759,875)	(69,287)
Tatimi mbi fitimin			
<i>Shpenzimi i tatim fitimit te periudhes</i>		-	-
Fitimi/(Humbja) e vitit		(7,759,875)	(69,287)

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 deri 19 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Bucaj International Shpk

Pasqyra e te ardhurave te tjera gjithepershireshe per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019

(Vlerat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

Pasqyra e te ardhurave te tjera gjithepershireshe

	Per periudhen 1 janar 2019 deri me 31 dhjetor 2019	Per periudhen nga 3 dhjetor 2018 deri me 31 dhjetor 2018 Te pa audituara
Fitimi/(Humbja) i/e vitit	(7,759,875)	(69,287)
Te ardhura te tjera gjithepershireshe	-	-
Totali i te ardhurave/(humbjeve) gjithepershireshe per vitin	(7,759,875)	(69,287)

Pasqyra e te ardhurave te tjera gjithepershireshe duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 deri 19 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Bucaj International Shpk

Pasqyra e kapitalit per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019

(Vlerat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital

	Kapitali themeltar I paguar	Kapitali themeltar I pa paguar	Fitimi/(Humbja) e vitit	Totali
Pozicioni financiar me 3 dhjetor 2018	-	100,000	-	100,000
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te vitit :				
Humbja e vitit 2018	-	-	(69,287)	(69,287)
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per vitit	-	-	(69,287)	(69,287)
Pozicioni financiar me 31 Dhjetor 2018	-	100,000	(69,287)	30,713
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te vitit :				
Humbja e vitit 2019	-	-	(7,759,875)	(7,759,875)
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per vitit	-	-	(7,759,875)	(7,759,875)
Rritje kapitali	62,217,500	60,882,500	-	123,100,000
Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike	62,117,500	60,982,500	-	123,100,000
Pozicioni financiar me 31 Dhjetor 2019	62,217,500	60,982,500	(7,829,163)	115,370,837

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 deri 19 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Bucaj International Shpk

Pasqyra e kapitalit per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019

(Vlerat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital

	Kapitali themeltar I paguar	Kapitali themeltar I pa paguar	Fitimi/(Humbja) e vitit	Totali
Pozicioni financiar me 3 dhjetor 2018	-	100,000	-	100,000
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te vitit :				
Humbja e vitit 2018	-	-	(69,287)	(69,287)
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per vitit	-	-	(69,287)	(69,287)
Pozicioni financiar me 31 Dhjetor 2018	-	100,000	(69,287)	30,713
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te vitit :				
Humbja e vitit 2019	-	-	(7,759,875)	(7,759,875)
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per vitit	-	-	(7,759,875)	(7,759,875)
Rritje kapitali	62,217,500	60,882,500	-	123,100,000
Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike	62,117,500	60,982,500	-	123,100,000
Pozicioni financiar me 31 Dhjetor 2019	62,217,500	60,982,500	(7,829,163)	115,370,837

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 deri 19 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Bucaj International Shpk

Pasqyra e flukseve monetare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019

(Vlerat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

Pasqyra e flukseve monetare

Shenime	Per periudhen 1 janar 2019 deri me 31 dhjetor 2019	Per periudhen nga 3 dhjetor 2018 deri me 31 dhjetor 2018 Te pa audituara
Fluksi mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit:		
Fitimi/(Humbja) i periudhes	(7,759,875)	(69,287)
<i>Rregullime per shpenzimet jo-monetare:</i>		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	11,12 6,360,235	-
Fluksi i mjeteve monetare i perfshire ne aktivite investuese		
<i>Ndryshimet ne aktivet dhe detyrimet e shfrytezimit</i>		
Renie/(Rritja) e kerkesave per arketim	7 (27,560)	(1,599,885)
Renie/(Rritja) e kerkesave per arketim te tjera	8 (16,296,910)	(100,000)
Rritja ne inventar	10 (11,334,915)	-
(Renie)/Rritja e llogarive te pagueshme	14,15 54,949,608	1,761,620
Mjete monetare neto nga veprimtarite e shfrytezimit	25,890,583	(7,552)
Fluksi i mjeteve monetare nga/ perdorur ne aktivitetin e investimit		
Pagesa per blerjen e aktiveve afatgjata materiale	11,12 (82,930,226)	(92,448)
Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e investimit	(82,930,226)	(92,448)
Fluksi i mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e financimit		
Arketime nga emetimi i kapitalit te nenshkruar	16 100,000	-
Rritje e kapitalit te paguar	16 62,117,500	100,000
Hua te marra	13 1,156,815	-
Mjete monetare perdorur ne veprimtarite financuese	63,374,315	100,000
(Renia)/Rritja neto e mjeteve monetare	6,334,671	-
Mjete monetare ne fillim te vitit	-	-
Mjete monetare ne fund te vitit	6,334,671	-

Pasqyra e flukseve monetare duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 deri 19 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare,

Bucaj International Shpk

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019

(Vlerat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

1. Informacion i pergjithshem

Bucaj International Shpk ("Shoqeria") u themelua me 3 dhjetor me aktivitet primar restorante dhe sherbime ndihmese, furnizim me ushqim me porosi, perpunim i produkteve te tjera ushqimore, tregti me pakice ne dyqane ku mbizoteron ushqimi dhe pijet, si dhe import-eksport i produkteve dhe nenprodukteve ushqimore.

Kapitali i Shoqerise Bucaj International shpk eshte 123,200,000 Lek dhe zoterohet nga aksioneri i vetem i shoqerise Balkan Foods L.L.C.

Shoqeria eshte e regjistruar ne organet tatimore me numer identifikimi L82403024E dhe zyra e regjistrimit te shoqerise eshte ne Bulevardin "Deshmoret e Kombit", Twin Towers, Kulla nr.2, Nr.29 Tirane, Shqiperi.

Perfaqesuesi ligjor i shoqerise eshte Z. Shkumbin Mucolli.

Shoqeria me 31 Dhjetor 2019 punesonte 60 punonjes (2018: 1 punonjes).

Pasqyrat financiare te shoqerise per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019 jane miratuar nga Administratori ne 25 korrik 2020.

2 Baza e pergatitjes

Pasqyrat financiare individuale jane pergatitur bazuar ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) te permireshuara, te aplikueshme per pasqyrat financiare qe mbulojne periudhat duke filluar nga 1 Janar 2015.

(a) Baza e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike.

(b) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare paraqiten ne Lek,, e cila eshte monedha funksionale per Shoqerine.

(c) Perdorimi i vleresimeve dhe gjykimeve

Pergatitja e pasqyrave financiare ne perputhje me SKK kerkon qe drejtimi te kryeje gjykime, çmuarje dhe supozime te cilat ndikojne ne aplikimin e politikave dhe shumave te raportuara te aktiveve dhe detyrimeve,, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund te ndryshojne nga keto çmuarje, Çmuarjet dhe supozimet rishikohen ne menyre te vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabel njihen ne periudhen ne te cilen vleresimi rishikohet dhe ne periudhat e ardhme nese ato ndikohen.

3 Permbledhje e politikave kontabel

(a) Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Zerat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar (shih me poshte) dhe humbjet e akumuluar nga zhvleresimi (shih politiken kontabel (c)).

Kosto perfshin shpenzime qe jane drejtperdrejt te ngarkueshme per blerjen e aktivitet. Kosto e aktiveve te ndertuara nga vete shoqeria perfshin koston e materialeve dhe te fuqise punetore, si dhe ndonje kosto tjeter qe lidhet drejtperdrejt me venien e aktivitet ne vendin dhe kushtet e nevojshme qe ai te jete i perdorshem ne menyren e synuar nga drejtimi dhe kosto te kapitalizuara te huamarrjes.

Bucaj International Shpk

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019

(Vlerat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

3 Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

Kur pjese te nje elementi te aktiveve afatgjata materiale kane jetegjatesine e dobishme te ndryshme, ato kontabilizohen si elemente te vecanta te aktiveve afatgjata materiale.

Fitimi ose humbja nga shitja e nje aktivi afatgjate material percaktohet duke krahasuar arketimet nga shitja me vleren kontabel te aktivitet afatgjate material, dhe njihet neto ne te ardhura/shpenzime te tjera ne fitim ose humbje.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zevendesimit te nje pjese te nje elementi te aktiveve afatgjata materiale njihet ne vleren mbartur te elementit nese eshte e mundshme qe perfitime ekonomike ne te ardhmen qe i atribuohen atij elementi do te rrjedhin ne shoqëri, dhe kostoja e tij mund te matet me besueshmeri. Kostot e sherbimeve ditore te aktiveve afatgjata materiale njihen ne fitim ose humbje ne momentin kur ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi njihet ne fitim ose humbje me metodën e zvogelimit te teprices. Metodën e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur (nese nuk eshte e pakonsiderueshme) jane rivleresuar ne datën e raportimit. Amortizimi llogaritet duke filluar nga dita e pare e muajit qe pason muajin e blerjes apo te vënies ne përdorim, dhe nuk llogaritet ne raste te jashtzakonshme kur ka ndërprerje te veprimtarisë per nje periudhe prej te pakten tre muaj. Toka nuk amortizohet.

Me poshte jane normat e amortizimit te aplikuar:

• Makineri e pajisje	20%
• Mjete transporti	20%
• Pajisje informatike	25%
• Pajisje zyre	20%
• Te tjera	20%
• Aktivitet jomateriale	10%

(b) Instrumentat financiare

Shoqeria mban vetem instrumente financiare jo-derivative

(i) Aktivitet financiare jo-derivative

Shoqeria njeh fillimisht llogarite e arketueshme ne datën kur ato lindin. Te gjithë aktivitet e tjera financiare njihen fillimisht ne datën e transaksionit e cila eshte data kur Shoqeria behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit.

Shoqeria nuk e njeh me nje aktiv financiar kur te drejtat kontraktuale ndaj flukseve monetare qe rrjedhin nga aktivitet financiar mbarojne, ose kur Shoqeria i transferon aktivitet financiar nje pale tjetër, pa mbajtur kontrollin ose te gjitha risqet dhe perfitimet e aktivitet, Interesi i aktiveve financiare te transferuara qe eshte krijuar ose mbajur nga Shoqeria njihet si nje aktiv ose detyrim i vecante. Aktivitet dhe detyrimet financiare netohen dhe vlera neto paraqitet ne pasqyren e pozicionit financiar atehere dhe vetem atehere kur Shoqeria ka nje te drejte ligjore te netoje vlerat dhe ka per qellim te shlyhet ne baze neto ose te arketoje aktivitet dhe paguaje detyrimin njekohesisht.

Shoqeria zoteron aktive financiare jo-derivative si me poshte: mjete monetare dhe ekuivalente me to; kerkesa per arketim.

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to perfshijne vlerat ne arke dhe llogari rrjedhese ne banka, me maturitet origjinal tre muaj ose me pak, dhe mbahen me koston e amortizuar.

Kerkesat per arketim njihen fillimisht me vleren e drejte dhe ne vijim me kosto te pakesuara per humbjet per zhvleresime.

Bucaj International Shpk

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019

(Vlerat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

3 Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

(i) Aktivet financiare jo-derivative (vazhdim)

Kërkesat për arkëtim njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me përvetësimin e tyre dhe në vijim maten me kosto të amortizuara pakësuar për humbjet për zhvlerësime.

(ii) Detyrimet financiare jo-derivative

Detyrimet financiare njihen fillimisht ne datën e transaksionit, e cila është data kur Shoqëria behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit. Shoqëria nuk e njeh më një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale të Shoqërisë janë shlyer ose janë anuluar.

Aktivitet dhe detyrimet financiare netohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka një të drejtë ligjore të netojë vlerat dhe ka për qëllim të shlyhet në bazë neto ose të arkëtojë aktivin dhe paguajë detyrimin njëkohësisht.

Detyrimet financiare jo-derivative perbehen nga detyrimet ndaj paleve te lidhura dhe llogari te pagueshme, Këto detyrime financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me përvetësimin e tyre, dhe në vijim maten me kosto të amortizuara.

(iii) Kapitali aksioner

Kapitali aksioner i Shoqërisë njihet me vlerën nominale

(c) Zhvlerësimi

(i) Aktivet financiare jo-derivative

Një aktiv financiar që nuk mbahet me vlerën e drejtë përmes fitimit humbjes vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidencë objektive që ai është zhvlerësuar. Një aktiv financiar është zhvlerësuar nëse evidencë objektive tregon se një ngjarje zhvlerësimi ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit, dhe që ngjarja e zhvlerësimit ka një ndikim negativ në flukset e ardhshme të mjeteve monetare të aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Evidenca objektive që aktivitetet financiare janë të zhvlerësuara mund të përfshijë mospagesa ose vështirësi financiare të debitorëve. Ristrukturimin e një shume me kushte dhe afate të cilat Shoqëria nuk do t'i kishte dhënë ndryshe, të dhëna që një debitor po falimenton, ndryshime të pafavorshme në aftësitë paguese të huamarrësve të Shoqërisë.

Shoqëria konsideron evidencën e zhvlerësimit për llogaritë e arkëtueshme si individualisht ashtu edhe në mënyrë kolektive. Të gjitha llogaritë e arkëtueshme të cilat janë individualisht të rëndësishme vlerësohen individualisht për zhvlerësim specifik. Të gjitha llogaritë e arkëtueshme individualisht të rëndësishme që rezultojnë të mos jenë individualisht të zhvlerësuara vlerësohen më pas në mënyrë kolektive për ndonjë zhvlerësim që ka ndodhur por nuk është identifikuar ende. Të gjitha llogaritë e arkëtueshme të cilat nuk janë individualisht të rëndësishme vlerësohen në mënyrë kolektive duke grupuar së bashku llogaritë e arkëtueshme që kanë karakteristika të ngjashme rreziku.

Për vlerësimin e zhvlerësimit kolektiv Shoqëria përdor modele statistikore të përvojës historike të humbjes, periudhën e rimarrjes dhe vlerën e humbjes, duke përfshirë dhe gjykimin e drejtuesve nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kreditimit janë të tilla që humbjet aktuale të ketë gjasa të jenë më të mëdha ose më të vogla se ato të përcaktuara nga modelimi historik.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktiviteti financiar të matur me koston e amortizuara është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës kontabel dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare skontuar me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit financiar. Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe pasqyrohen në një llogari provigjoni përkundrejt llogarive të arkëtueshme. Interesat mbi aktivitetet e zhvlerësuara vazhdojnë të njihen. Kur një ngjarje pas datës së raportimit (p.sh, pagesa nga një debitor) tregon për zvogëlim të zhvlerësimit, zvogëlimi i zhvlerësimit anulohet nëpërmjet fitimit ose humbjes,

Bucaj International Shpk

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019

(Vlerat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

3 Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

(c) Zhvleresimi (vazhdim)

(ii) Aktivitet jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është me e madhja ndërmjet çmimit neto të shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e çmuara të ardhshme të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për aktivin ose njësinë gjeneruese të mjeteve monetare. Per qellime të rishikimit për zhvlerësim, aktivitetet që nuk mund të testohen individualisht grupohen së bashku në grupin më të vogël të aktiveve që gjenerojnë mjete monetare nga përdorimi i vazhdueshëm të cilat janë të pavarura nga flukset monetare të aktiveve të tjera.

(d) Njohja e te ardhurave

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të parave të marra ose të arkëtueshmeve nga shoqëria për mallrat e dhëna ose shërbimet e kryera, duke përfshirë taksat e shitjes, rabatet, dhe uljet tregtare.

E ardhura nga shitja e mallrave njihet kur mallrat janë dhene dhe përfitimet dhe rreziqet kryesore që lidhen për pronësinë e mallit janë transferuar tek blerësi. E ardhura nga kryerja e shërbimeve njihet kur shërbimi kryhet dhe në raport me fazën e përfundimit.

(e) Përfitimet e punonjesve

Sigurimet shoqerore te detyrueshme

Shoqëria paguan vetëm kontributet për sigurimet shoqerore të detyrueshme që përcaktojnë përfitimet e punonjesve që dalin në pension. Qeveria Shqiptare është përgjegjëse për përcaktimin e limitit ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar. Kontributet e Shoqërisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

Leje vjetore te paguara

Shoqëria njihet si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të vlerësuar në lidhje me lejet vjetore që pritet të paguhet në këmbim për shërbimin e punonjesve gjatë periudhës.

(f) Shpenzimet

Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen kur ato ndodhin.

Shpenzimet e qirase

Shpenzimet e qirase së zakonisht janë ngarkuar në fitim ose humbje në mënyrë lineare gjatë periudhës së qirase, Paga motivimi marre nga qiradhenesi janë njohur si pjesë perberese e shpenzimit total të qirase gjatë periudhës së qirase.

(g) Te ardhura dhe shpenzime financiare

Te ardhurat financiare përfshijnë te ardhurat nga interesi nga llogaritë në banka dhe fitimet nga kursi i këmbimit që njihen në fitim ose humbje. Te ardhurat nga interesi njihen kur ai përfitohet duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Bucaj International Shpk

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019

(Vlerat ne Leke, nese nuk specifkohet ndryshe)

3 Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

(g) Te ardhura dhe shpenzime financiare

Shpenzimet financiare perfshijne shpenzimet e interesit per huate dhe humbjet nga kursi i kembimit. Te gjitha kostot e huave njihen ne fitim ose humbje duke perdorur metoden e interesit efektiv.

(h) Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin perfshin tatimin e periudhes aktuale dhe tatimin e shtyre. Tatimi mbi fitimin njihet ne fitim ose humbje pervec pjeses qe lidhet me zera te njohur direkt ne kapital ose ne te ardhura te tjera permbledhese.

Tatimi aktual eshte tatimi qe pritet te paguhet ose te arketohet mbi fitimin ose humbjen e tatueshme te vitit duke perdorur normen tatimore ne fuqi ose qe hyn ne fuqi menjehere ne daten e raportimit, dhe çdo sistemim te tatimit te pagueshem per vitet e meparshme.

Tatimi i shtyre eshte njohur ne lidhje me diferencat e perkohshme ndermjet vleres kontabel neto te aktiveve dhe detyrimeve per qellime raportimi financiar dhe bazes tatimore. Shuma e tatimit te shtyre eshte llogaritur bazuar ne metoden e realizimit ose kompensimit te vlerave kontabel te aktiveve dhe detyrimeve, duke perdorur shkalle tatimore qe jane ne fuqi ose qe hyjne ne fuqi menjehere ne daten e raportimit.

Aktivet dhe pasivet tatimore të shtyra netohen nëse ekziston një e drejtë ligjore për të netuar detyrimet për tatimin aktual të pagueshëm ndaj tatimit të parapaguar, dhe ato lidhen me tatimin mbi të ardhurat që përcakton i njëjti autoritet tatimor mbi të njëjtin subjekt tatimpagues.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për humbjet fiskale të papërdorura, kreditime tatimore dhe diferenca të përkohshme të zbritshme për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit ato të mund të përdoren. Aktiv i tatimor i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet për aq sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

(i) Transaksionet ne monedha te huaja

Transaksionet ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e dates se transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e dates se raportimit. Fitimi apo humbja nga kursi i kembimit per zerat monetare eshte diferenca ndermjet kostove te amortizuara ne monedhen funksionale ne fillim te periudhes, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjate periudhes, dhe kostove te amortizuara ne monedhe te huaj te konvertuara me kursin e kembimit ne fund te periudhes. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare ne monedhe te huaj qe maten me vlere te drejte konvertohen ne monedhe funksionale me kursin e kembimit ne daten kur eshte vendosur vlere e drejte. Diferencat nga kursi i kembimit qe rrjedhin nga konvertimi njihen ne fitim ose humbje, pervec diferencave qe rrjedhin nga konvertimi i instrumenteve te kapitalit te vlefshme per shitje (nese ka).

4 Percaktimi i vleres se drejte

Vlera e drejte e aktiveve dhe detyrimeve financiare eshte perafersisht e barabarte me vleren kontabel per shkak te maturitetit te tyre te shkurter.

5 Manaxhimin i riskut financiar

Shoqeria eshte ekspozuar ndaj rreziqeve te meposhtme nga perdorimi i instrumenteve financiare:

- risku i kredise
- risku i likuiditetit
- risku i tregut

Bucaj International Shpk

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019

(Vlerat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

5 Manaxhimin i riskut financiar (vazhdim)

Ky shenim paraqet informacion rreth ekspozimit te Shoqerise ndaj secilit prej rreziqeve te mesiperm, objektivat, politikat dhe proceset e Shoqerise per matjen dhe menaxhimin e riskut, dhe menaxhimin e kapitalit, Shenime te metejshme sasiore jane te perfshira ne keto pasqyra financiare.

Politika e manaxhimit te riskut

Bordi i Drejtoresve mbart pergjegjesine e pergjithshme per vendosjen dhe mbikeqyrjen e politikave te Shoqerise per menaxhimin e riskut.

Politikat e menaxhimit te riskut te Shoqerise jane vendosur per te identifikuar dhe analizuar rreziqet qe perball Shoqeri, per te vendosur limitet dhe kontrollet e pershtatshme, dhe per te monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit te riskut rishikohen rregullisht per te reflektuar ndryshimet ne kushtet e tregut dhe ne aktivitetet e Shoqerise. Shoqeria, permes trajnimeve dhe standardeve dhe procedurave te menaxhimit, synon te zhvilloje nje ambient kontrolli konstruktiv dhe te disiplinuar ne te cilin gjithe punonjesit i kuptojne rolet dhe detyrimet e tyre.

Instrumentet financiare kryesore te Shoqerise konsistojne ne vlerat ne arke dhe ne banka, llogarite e arketueshme dhe te pagueshme dhe detyrime te tjera afatshkurtra.

Ndikimi ne likuiditet

Volumi i financimit nga shitesit e shumices ka rene ndjeshem kohet e fundit. Rrethana te tilla mund te ndikojne mundesine e Shoqerise per te marre hua te reja, nese do te jete e nevojshme, dhe te ri-financoje huate ekzistuese me kushte dhe afate te ngjashme me ato te aplikuar me pare.

Ndikimi ne klientet/huamarresit

Debitorët e Shoqerise mund te ndikohen nga situata e likuiditetit te ulet i cili mund te ndikojte aftesine e tyre per ripagimin e shumave qe detyrohen. Perkeqesimet e kushteve shfrytëzuese per klientet mund te ndikojne gjithashtu parashikimet e fluseve monetare nga drejtimi dhe vleresimin e zhvleresimit te aktiveve financiare dhe jo-financiare. Deri ne ate mase qe informacioni eshte i disponueshem, drejtimi ka reflektuar siç duhet vleresime te korrigjuara te flukseve monetare te pritshme ne vleresimet e zhvleresimit.

(i) Risku i kredise

Risku i mos-pagesës ekziston kur pala tjetër nuk mund të përmbushë detyrimet për pagesën e llogarive të arkëtueshme. Maksimumi i riskut të kredisë për instrumentet financiare jo-derivative është teorikisht i barabartë me vlerën e drejtë të të gjitha llogarive të arkëtueshme minus detyrimet kundrejt të njëjtit debitor kur kompensimi është i lejuar. Risku i kredisë i cili është identifikuar merret parasysh nëpërmjet zhvlerësimeve. Shoqëria e vlerëson cilësinë e llogarive të arkëtueshme që nuk janë me vonesë dhe as të zhvlerësuara si shumë të kënaqshme.

(ii) Risku i likuiditetit

Shoqeria duhet te permbushe nevojat per mjete monetare, kryesisht per kostot e shfrytezimit qe rrjedhin nga aktivitetet e publicitetit. Ekziston rreziku qe mjetet monetare mund te mos jene te disponueshme per te shlyer detyrimet ne kohen e duhur me nje kosto te arsyeshme. Shoqeria monitoron likuiditetin ne baza periodike ne menyre qe te menaxhoje detyrimet e saj kur ato kerkohen.

Bucaj International Shpk

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019

(Vlerat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

5 Manaxhimin i riskut financiar (vazhdim)

(iii) Risku i tregut

Risku i normave te interesit

Shoqeria nuk disponon instrumente financiare me interes me 31 Dhjetor 2019 dhe 2018.

Risku i kursit te kembimit

Shoqeria ndermerr transaksione ne Lek, Euro dhe USD. Risku i pozicionit valutor menaxhohet nepermjet parimit te perputhjes se aktiveve me detyrimet. Shoqeria nuk ka hyre ne ndonje marreveshje derivative per kontrata te ardhshme shkembimi me 31 Dhjetor 2019.

Analiza e ndjeshmerise

Me anen e menaxhimit te riskut te normave te interesit dhe te pozicionit valutor. Shoqeria synon te reduktoje ndikimin e luhatjeve afatshkurtra ne fitimet e Shoqerise. Ne nje periudhe afatgjate, sidoqofte, ndryshimet e perhershme ne kurset e kembimit dhe normat e interesit mund te kene nje ndikim ne fitim. Me 31 Dhjetor 2019 Shoqeria nuk disponon instrumente financiare me interes.

(iv) Manaxhimi i kapitalit

Politika e Shoqerise eshte te mbaje nje baze te forte kapitali ne menyre qe te ruaje besueshmerine e investitoreve dhe kreditoreve dhe te mbeshtese zhvillimin e metejshem te biznesit. Bordi i Drejtoreve monitoron kthimet nga kapitali te cilat Shoqeria i percakton si te ardhura neto te shfrytezimit ndaj totalit te kapitalit.

Shoqeria nuk eshte subjekt i kerkesave te kapitalit te vendosura nga ente rregullatore.

6 Mjete Monetare

Mjete monetare perbehet si me poshte:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018 Te pa audituara
Vlera në arkë	1,826,611	-
Vlera në banka	4,508,060	-
<i>Ne Lek</i>	4,243,482	-
<i>Ne Euro</i>	264,578	-
Totali	6,334,671	-

7 Te drejta te arketueshme tregtare

Kerkesa tregtare per arketim perbehet si me poshte:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018 Te pa audituara
Kliente	27,560	-
Totali	27,560	-

Bucaj International Shpk

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019

(Vlerat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

8 Te drejta te arketueshme te tjera

Kerkesa te tjera per arketim perbehet si me poshte:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018 Te pa audituara
TVSH e arketueshme, neto	8,861,029	287,699
Parapagime dhe shpenzime te shtyra	7,485,766	1,312,186
Paradhenie per punonjesit	800,000	-
Tatimi mbi fitimin i arketueshem	750,000	-
Totali	17,896,795	1,599,885

TVSH e arketueshme, neto

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018 Te pa audituara
TVSH e pagueshme mbartur nga viti paraardhes	287,699	-
TVSH e llogaritur	(20,117,153)	-
TVSH i zbritshem blerje	28,690,483	287,699
TVSH e arketueshme, Neto	8,861,029	287,699

9 Te drejta te arketueshme nga palet e lidhura

Te drejta te arketueshme nga palet e lidhura perbehet si me poshte:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018 Te pa audituara
Kapital I nenshkruar I papaguar	60,982,500	100,000
Totali	60,982,500	100,000

10 Inventar

Inventari perbehet si me poshte :

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018 Te pa audituara
Lende e pare	7,674,809	-
Inventar I imet	1,908,013	-
Materiale ndihmese	1,752,093	-
Totali	11,334,915	-

Bucaj International Shpk

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019

(Vlerat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

11 Aktive materiale

Aktivitet afatgjata materiale perbehen nga sa me poshtë:

	Makineri dhe pajisje	Mobilje dhe orendi	Pajisje informatike	Te tjera	Totali
Kosto					
Me 3 dhjetor 2018	-	-	-	-	-
Shtesa	-	-	-	92,448	92,448
Pakesime	-	-	-	-	-
Me 31 Dhjetor 2018	-	-	-	92,448	92,448
Shtesa	33,538,387	8,981,361	6,287,857	31,270,173	80,077,778
Pakesime	-	-	-	-	-
Me 31 Dhjetor 2019	33,538,387	8,981,361	6,287,857	31,362,621	80,170,226
Amortizimi i akumuluar					
Me 3 dhjetor 2018	-	-	-	-	-
Amortizimi per vitin	-	-	-	-	-
Me 31 Dhjetor 2018	-	-	-	-	-
Amortizimi per vitin	(3,164,677)	(917,972)	(645,437)	(1,469,348)	(6,197,434)
Pakesime	-	-	-	-	-
Me 31 Dhjetor 2019	(3,164,677)	(917,972)	(645,437)	(1,469,348)	(6,197,434)
Vlera kontabel neto:					
Me 31 Dhjetor 2018	-	-	-	92,448	92,448
Me 31 Dhjetor 2019	30,373,710	8,063,389	5,642,420	29,893,273	73,972,791

Bucaj International Shpk

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019

(Vlerat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

12 Aktive jomateriale

	Aktive jomateriale	Total
Kosto		
Me 3 dhjetor 2018	-	-
Shtesa	-	-
Me 31 Dhjetor 2018	-	-
Shtesa	2,852,448	2,852,448
Me 31 Dhjetor 2019	2,852,448	2,852,448
Amortizimi i akumuluar		
Me 3 dhjetor 2018	-	-
Amortizimi per vitin	-	-
Me 31 Dhjetor 2018	-	-
Amortizimi per vitin	(162,801)	(162,801)
Me 31 Dhjetor 2019	(162,801)	(162,801)
Vlera kontabel neto:		
Me 31 Dhjetor 2018	-	-
Me 31 Dhjetor 2019	2,689,647	2,689,647

13 Hua afatshkurter

Hua afatshkurter perbehet si me poshte:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018 Te pa audituara
Hua afatshkurter	1,156,815	-
Totali	1,156,815	-

14 Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit

Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit perbehet si me poshte:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018 Te pa audituara
Furnitore	18,110,579	1,726,195
Paga e shperblime	274,939	28,729
Sigurime shoqerore dhe shendetsore	839,743	6,696
Tatim mbi te ardhurat e personale	197,915	-
Taksa dhe tatime	484,035	-
Totali	19,907,211	1,761,620

Bucaj International Shpk

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019

(Vlerat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

15 Te pagueshme per palet e lidhura

Te pagueshme per palet e lidhura perbehet si me poshte:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018 Te pa audituara
Bucaj Retail shpk	23,466,970	-
Balkan Foods L.L.C	13,337,047	-
Totali	36,804,017	-

16 Kapitali i nenshkruar

Kapitali i Shoqerise me 31 Dhjetor 2019 eshte 123,200,000 Lek (31 dhjetor 2018 :100,000 Lek) i ndare ne 100 aksione te zakonshme me vlere nominale 1,232,000 Lek secili dhe zoterohet 100% nga aksioneri i vetem Balkan Foods L.L.C. Nga ky kapital shoqeria me 31 dhjetor 2019 ka kapital te nenshkruar te paguar ne vleren prej 62,217,500 Lek (31 dhjetor 2018 :0 Lek) dhe kapital i nenshkruar i papaguar ne vleren prej 60,982,500 Lek (31 dhjetor 2018 :100,000 Lek).

17 Te ardhura nga aktiviteti kryesor

Te ardhurat nga aktiviteti perbehen si me poshte :

	Per periudhen 1 janar 2019 deri me 31 dhjetor 2019	Per periudhen nga 3 dhjetor 2018 deri me 31 dhjetor 2018 Te pa audituara
Produkt i gatshem	99,540,105	-
Totali	99,540,105	-

18 Te ardhura te tjera

Te ardhurat e tjera perbehen si me poshte :

	Per periudhen 1 janar 2019 deri me 31 dhjetor 2019	Per periudhen nga 3 dhjetor 2018 deri me 31 dhjetor 2018 Te pa audituara
Te ardhura nga promocioni	1,876,511	-
Te ardhura te ndryshme	1,652,352	-
Totali	3,528,863	-

Bucaj International Shpk

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019
(Vlerat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

19 Lende e pare dhe materiale te konsumueshme

Lende e pare dhe materiale te konsumueshme perbehet si me poshte :

	Per periudhen 1 janar 2019 deri me 31 dhjetor 2019	Per periudhen nga 3 dhjetor 2018 deri me 31 dhjetor 2018 Te pa audituara
Lende e Pare	43,383,039	-
Uje dhe energji elektrike	3,171,474	-
Te tjera	2,901,551	-
Totali	49,456,065	-

20 Shpenzime te personelit

Shpenzime te personelit perbehen si me poshte :

	Per periudhen 1 janar 2019 deri me 31 dhjetor 2019	Per periudhen nga 3 dhjetor 2018 deri me 31 dhjetor 2018 Te pa audituara
Pagat dhe shperblimet e personelit	18,706,363	24,000
Sigurimet shoqerore dhe shendetesore	4,377,590	4,008
Totali	23,083,953	28,008

21 Shpenzime te pergjithshme dhe administrative

Shpenzimet e pergjithshme dhe administrative jane te analizuara si me poshte:

	Per periudhen 1 janar 2019 deri me 31 dhjetor 2019	Per periudhen nga 3 dhjetor 2018 deri me 31 dhjetor 2018 Te pa audituara
Qira	8,604,533	33,862
Shpenzime per patenta dhe licenca BK	4,958,312	-
Shpenzime per personel	4,438,625	-
Publicitet, reklama	8,499,051	-
Shpenzime ligjore dhe sherbime te tjera	2,382,104	-
Shpenzime transporti	1,062,706	-
Transferime, udhetim, dieta	439,480	-
Sherbime bankare	397,717	-
Shpenzime per pritje dhe perfaqesime	360,496	-
Mirembajtje dhe riparime	356,300	-
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	241,267	-
Taksa dhe tarifa vendore	219,496	7,417
Gjoha dhe demshperblime	115,383	-
Totali	32,075,470	41,279

Bucaj International Shpk

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019

(Vlerat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

22 Shpenzime financiare, neto

Shpenzimet financiare perbehen si me poshte :

	Per periudhen 1 janar 2019 deri me 31 dhjetor 2019	Per periudhen nga 3 dhjetor 2018 deri me 31 dhjetor 2018 Te pa audituara
Humbje nga kembimet valutore	(1,129,419)	-
Fitim nga kembimet valutore	1,326,630	-
Shpenzime interesi	(50,331)	-
Totali	146,880	-

23 Palet e lidhura

Balancat dhe transaksionet me palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018 Te pa audituara
Të arkëtueshme nga palët e lidhura		
Balkan Food L.L.C	-	-
Bucaj Retail shpk	-	-
	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018 Te pa audituara
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura		
Balkan Food L.L.C	13,337,047	-
Bucaj Retail shpk	23,466,970	-
	36,804,017	-
	Per periudhen 1 janar 2019 deri me 31 dhjetor 2019	Per periudhen nga 3 dhjetor 2018 deri me 31 dhjetor 2018 Te pa audituara
Shitje ndaj palëve të lidhura		
Balkan Food L.L.C	-	-
Bucaj Retail shpk	-	-
	-	-
	Per periudhen 1 janar 2019 deri me 31 dhjetor 2019	Per periudhen nga 3 dhjetor 2018 deri me 31 dhjetor 2018 Te pa audituara
Blerje nga palët e lidhura		
Balkan Food L.L.C	13,337,047	-
Bucaj Retail shpk	23,466,970	-
	36,804,017	-

Bucaj International Shpk

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019

(Vlerat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

24 Ngjarje pas dates se raportimit

Ne 11 Mars 2020, Organizata Boterore e Shendetit (OBSH) deklaroi gjendjen e pandemisë globale per shkak te Noveles se Covid-19. Kjo ngjarje ndikoi edhe Shqiperine, gje e cila ka krijuar vështirësi ne aktivitetin e bizneseve per shkak te masave izoluese te marra nga Qeveria Shqiptare, per parandalimin e përhapjes se këtij virusi. Akoma nuk mund te vlerësohet sakte sa do te zgjasë kjo situatë dhe ndikimi i saj ne biznes përgjatë vitit operacional 2020.

Kjo ngjarje ka patur nje efekt te menjëhershëm ne zinxhirin ekonomik te vendit dhe përtej, si edhe ne aktivitetin e Shoqerise Bucaj International". Ndikimet e para por qe akoma nuk jane vlerësuar dhe kuantifikuar plotësisht nga kompania jane si me poshte vijon:

Shitjet e kompanise per rreth 2 muaj (12 Mars 2020- 4 Maj 2020) kane qene zero, kjo per arsye te vendimit te qeverise per mbylljen e qendrave tregtare. Dhe aktualisht kompania jone ushtron aktivitetin e saj vetem ne qendra tregtare.

Shitjet aktuale krahasuar me nje vit me pare jane ulur me rreth 40%.

Per kete shoqeria mori këto masa te menjershme me synim përputhjen me masat izoluese parandaluese si edhe vazhdimësinë e biznesit ne kushtet e reja te formuara. Krijimin e nje infrastrukture te pershtatshme per te ofruar sherbimin delivery edhe ne rast te nje mbyllje te dyte te qendrave tregtare nga qeveria. Kjo infrastrukture do te lejoj ushtrimin e aktivitetit pa nderprerje duke mundesuar qe shoqeria te kete likuditet mjaftueshem per te mbajtur ne pune punonjesit dhe per te gjeneruar te ardhura per vazhdimesine e bisnesit ne teresi.